



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Besioni" Sh.P.K. të datës 12.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i rrugës Ilir Konushevcit dhe ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna" me nr. të prokurimit 616-23-429-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 009 521, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET PJSËRISHT** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Besioni" Sh.P.K. e datës 12.04.2023 përkatësisht kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i rrugës Ilir Konushevcit dhe ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna" me nr. të prokurimit 616-23-429-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 009 521, ashtu që **MIRATOHET** si i bazuar pretendimi i parashtruesit lidhur me lot 2 ndërsa **REFUZOHEN** si të pabazuara pretendimet tjera të parashtruesit që janë të ndërlidhura me lot 1 të këtij aktiviteti të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim lotin 2 të aktivitetit të prokurimit si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Besioni" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Besioni" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 12.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i rrugës Ilir Konushevcit dhe ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna" me nr. të prokurimit 616-23-429-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 009 521.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit kanë të bëjnë me të dy lotet e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimet lidhur me lot 1 janë si në vijim: GOE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me FDT pasi që *"Elektroingjinjeri i prezentuar nga GOE është me drejtim automekanikë me elektroteknikë kurse kërkesa në FDT është elektroingjinjer me drejtim energjetike"*. Po ashtu *"Për menagjerin e projektit nuk ka prezentuar asnjë referencë pune siq kërkohet në FDT"*. Tutje *"Plani dinamik i prezentuar nga GOE nuk është prezentuar sipas kërkesës së AK"*. Ndërsa *"Aneksi 7 të pajisjet dhe makineria nuk është plotësuar sipas kërkesës së AK në kolonën D nuk janë përshkruar fare shënimet e kërkuara nga AK..."*

Ndërsa pretendimi lidhur me lot 2 është cituar si në vijim: *"Operatori që është shpallur fitues në Lotin 1 të këtij tenderi është me çmim mbi vlerën e parashikuar të projektit, prandaj në si OE me këtë vendim jemi trajtuar jo në mënyrë të barabartë sipas nenit 7 par. 1, 2 dhe 3 të LPP"*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale si në vijim:

- Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të datës 30.01.2023;
- Oferta e GOE "FS C ING SHPK & Ibrahim Kurrumeli B.I" i rekomanduar për kontratë;
- Raporti i komisionit për vlerësim i datës 06.04.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 07.04.2023;
- Konfirmimi nga njësia kërkuuese për vazhdimin e lot 2 i datës 13.04.2023.

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i bazuar në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Me qëllim që të shqyrtohen pretendimet e parashtruesit lidhur me lot 1 janë administruar si prova materiale njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të datës 30.01.2023, pastaj oferta e GOE "FS C ING SHPK & Ibrahim Kurrumeli B.I" të cilët janë rekomanduar për kontratë si dhe raporti i komisionit për vlerësim i datës 06.04.2023. Me këtë rast është gjetur se asnjë nga pretendimet e parashtruesit lidhur me lot 1 nuk janë të qëndrueshme

pasi që nga provat materiale të administruara nuk është arritur që të vërtetohen këto pretendime. Komisioni vlerësues në raportin e vet ka evidentuar se të gjitha kriteret e kontestuar sipas pretendimeve të parashtruesit janë plotësuar në përputhje me dosjen e tenderit dhe fletën e të dhënave të tenderit. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo provë me të cilën do të mund të vërtetonte pretendimet e veta lidhur me lot 1 të këtij aktiviteti të prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se të gjitha pretendimet e parashtruesit lidhur me lot 1 janë tërësisht të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me lot 2 janë administruar si prova raporti i komisionit për vlerësim i datës 06.04.2023, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 07.04.2023 si dhe konfirmimi nga njësia kërkuuese i datës 13.04.2023 se mund të vazhdohet me lot 2 përkundër tejkallimit të buxhetit të planifikuar fillimisht për këtë aktivitet të prokurimit. Fillimisht është gjetur se për të dy lotet në këtë aktivitet të prokurimit është tejkalluar buxheti nga ofertat e përgjegjshme të tenderuesve. Megjithatë në faqe 12 të raportit të komisionit evidentohet se pavarësisht këtij fakti, për lot 1 është rekomanduar si tenderues i suksesshëm GOE "FS C ING SHPK & Ibrahim Kurrumeli B.I", ndërsa për lot 2 thuhet se "Lot 2 do të anulohet për shkak të tejkallimit të vlerës së parashikuar". Përmes nenit 43.7 të RRPP është përcaktuar si në vijim "*Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK*". Megjithatë nga interpretimi gjuhësor dhe qëllimor i kësaj dispozite rezulton se anulimi mund të bëhet vetëm nëse AK nuk ka buxhet për të mbuluar ofertat e tenderëve të përgjegjshëm në një aktivitet të prokurimit. Ky fakt nuk është fare kontestues pasi që vet komisioni i vlerësimit për lot 1 ka rekomanduar si fitues një tenderues i cili ka ofertuar me një çmim i cili ka tejkalluar buxhetin fillestar të planifikuar nga AK. Një veprim i tillë ka ndodhur pasi që njësia kërkuuese e AK ka konfirmuar se ka buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet përkatëse lidhur me lot 1. Rrjedhimisht komisioni vlerësues sa i përket këtij aspekti ka vepruar në përputhje me RRPP dhe LPP. Me këtë rast duhet theksuar se me datë 13.04.2023 njësia kërkuuese përmes adresës zyrtare elektronike ka konstatuar se çmimet e tregut lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe çmimet e vendosura në paramasë dhe parallogari janë në disproporcion të theksuar me njëra tjetrën. Rrjedhimisht njësia kërkuuese ka konfirmuar se ka buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet edhe sa i përket lot 2 të aktivitetit të prokurimit. Me këtë rast është konfirmuar se nuk ekzistojnë arsye për anulimin lot 2 për shkak të mungesës së buxhetit të AK sikurse që është konstatuar në faqen 12 në raportin e komisionit vlerësues. Me fjalë të tjera anulimi i lot 2 sipas rekomandimit të komisionit vlerësues për shkak të mungesës së buxhetit është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 43.7 të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme apo prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij lidhur me lot 1. Po ashtu nga provat materiale të administruara në këtë rast nuk është arritur të konfirmohen pretendimet e parashtruesit lidhur me lot 1. Prandaj të gjitha pretendimet e parashtruesit të cilat i referohen lot 1 për këtë aktivitet të prokurimit janë pretendime të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar në tërësi.

Në anën tjetër është gjetur parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij lidhur me lot 2. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është konfirmuar se pretendimi i parashtruesit lidhur me lot është tërësisht i bazuar. Kjo pasi që është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 43.7 lidhur me nenin 4.1 dhe 4.3. të RRPP. Për këto arsye kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është miratuar pjesërisht ashtu që janë miratuar pretendimet për lot 2 ndërsa janë refuzuar pretendimet për lot 1.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.04.2023

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.